



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

25/2020



Fshehja e kundërligjshme e shpenzimeve publike për mbrojtësit e speciales



Prishtinë, dhjetor 2020

Autor: Lavdim Bajraktari

Ekipi redaktues: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Dhjetor, 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	4
2. Historiku i Speciales	5
3. Ftesat dhe aktakuzat e para të Speciales	6
4. Korniza ligjore për ndihmën e të akuzuarve të Speciales	6
5. “Konfidencialiteti” i shpenzimit të parasë publike për të akuzuarit e Speciales	8
6. Transparenca e munguar	9
6.1 Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....	12
7. Qasja selektive dhe mundësia për abuzimin e parave publike.....	13
8. Rekomandime	15

1. Përmbledhje ekzekutive

Miliona euro ndahen vit pas viti nga Buxheti i Kosovës për t'i mbuluar shpenzimet e mbrojtjes së të akuzuarve nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) me seli në Hagë, edhe pse jo çdo herë të njëjtat shpenzohen në tërësi. Së fundmi, nga Buxheti i Kosovës janë paraparë për këtë kategori të ndahen 20 milionë euro. Përveç kësaj shume, Ministria e Drejtësisë (MD) ka vendosur që krejt dokumentacionin lidhur me këto shpenzime ta mbaj të fshehur nga publiku.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 120 ka përcaktuar qartë se *“Shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës”*. Një qasje të tillë kundrejt transparencës për shpenzimet e miliona eurove të Buxhetit të Kosovës, MD e bazon në një vendim të ish-kryeministrit Ramush Haradinaj të janarit 2019, si dhe në një udhëzim administrativ që e ka nxjerr vet për këtë asistencë ndaj të akuzuarve.

Por, përkundër asaj që thonë nga MD, vendimi i ish-kryeministrit Haradinaj nuk e ka ndaluar publikimin e informacioneve që kanë të bëjnë me shpenzimet financiare lidhur me mbrojtjen juridike të akuzuarve të Speciales. Në vendimin e ish-kryeministrit që ceket nga MD, thuhet në mënyrë eksplicite se për dallim nga informacionet tjera që ndërliken me Dhomat e Specializuara e të cilat janë klasifikuar si “sekrete”, në atë vendim përjashtohen informacionet që kanë të bëjnë me shpenzimet për mbështetje financiare që ndërliken me Dhomat e Specializuar dhe ZPS-në. As vet Ligji nr.05/L-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar

Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, nuk ka paraparë në asnjë pjesë të tij se shpenzimet për këtë kategori të jenë konfidenciale dhe se nuk mund të bëhen publike.

Me gjithë këtë, udhëzimi administrativ nr.02/2020, që është nxjerrë nga MD, në nenin 17 të tij, ka paraparë që dokumentet që kanë të bëjnë me mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes do të trajtohen në harmoni me legjislacionin në fuqi për klasifikimin e informacioneve. Pa dhënë ndonjë elaborim shtesë se pse këto shpenzime që burojnë nga Buxheti i Kosovës, nuk mund të bëhen publike, MD ka refuzuar qasjen në këto dokumente për publikun. Madje, nga MD nuk është bërë asnjë sqarim se cili organ kompetent ka vendosur që këto dokumente lidhur me shpenzimet për mbrojtje të akuzuarve të Speciales të mbesin të klasifikuara, pasi që edhe vendim i ish-kryeministrit Haradinaj nuk i kishte klasifikuar informacionet lidhur me shpenzimet.

Për më tepër, mbajtja e fshehur e dokumentacionit të shpenzimeve për mbrojtjen e të akuzuarve të Speciales, nuk gjen mbështetje as në Ligjin për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë e as në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. Ky i fundit në mënyrë eksplicite e ka përcaktuar se qasja në dokumente publike lejohet nëse ka të bëjë me shpenzimet e parasë publike, çka është edhe rasti tek shpenzimet për mbrojtjen e të akuzuarve. Rrjedhimisht, mbajtja e fshehur e këtyre informacioneve dhe dokumenteve, e dëmton transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike përkritazi me shpenzimin e parasë publike dhe mund t'i hap rrugë edhe trajtimit të pabarabartë të akuzuarve dhe mundësisë së abuzimit me paratë publike.

2. Historiku i Speciales

Asambleja e Përgjithshme e Këshillit të Evropës, më 7 janar të vitit 2011 kishte miratuar një raport të raportuesit special, Dick Marty, në të cilin ishin ngritur dyshime për kryerjen e krimeve të luftës gjatë viteve 1998-2000.¹ Pas këtij raporti, në shtator 2011, Bashkimi Evropian (BE), kishte ngritur një Task Forcë Hetimore, e cila do të hetonte pretendimet e ngritura në raportin e senatorit Marty.

Pasi që në vitin 2014, Task Forca kishte ardhur në përfundim se ekzistojnë prova të mjaftueshme që mund të sjellin ngritjen e aktakuzave ndaj të dyshuarve potencial, kishte dalë në pah edhe nevoja e ngritjes së një institucioni, i cili do të bënte hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e këtyre pretendimeve. Në prill të vitit 2014, Presidentja e atëhershme e Kosovës, Atifete Jahjaga dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, Catherine Ashton, kishin shkëmbyer letra në lidhje me *“dhoma të veçanta gjyqësore”*, ndërsa në nëntor 2014 ishte formuar një ekipi planifikues për Gjykatën.²

Pas bisedimeve që ishin zhvilluar mes Kosovës dhe komunitetit ndërkombëtar, më 3 gusht 2015, Kuvendi i Kosovës kishte miratuar amendamentin kushtetues, përkatësisht nenin e ri 162 të Kushtetutës së Kosovës, me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, si dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe

Zyrën e Prokurorit të Specializuar, me 71 vota të deputetëve të Kuvendit. Kosova dhe Holanda në shkurt të vitit 2016, kishin arritur Marrëveshje në lidhje me Vendosjen e Institucionit Gjyqësor të Specializuar të Zhvendosur të Kosovës në Holandë. Në qershor 2017, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese kishte shqyrtuar Rregulloren së Procedurës dhe të Provave, gjë që i kishte hapur rrugë Dhomave të Specializuara të Kosovës për kryerjen e procedurave penale.

Kështu, Dhomat e Specializuara në Hagë, me seli në Hagë të Holandës, llogariten si gjykatë brenda sistemit gjyqësor të Kosovës dhe struktura e tyre është e njëjtë me gjykatat tjera në Kosovë, duke pasur kështu në vete, të tri instancat, Themelore, Apel dhe Supreme si dhe Dhomën Kushtetuese. Të njëjtat financohen kryesisht nga BE dhe kanë të punësuar vetëm staf ndërkombëtar.

Më 26 nëntor 2020, Dhoma e Specializuar e Gjykatës, kishte konfirmuar se mandati i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuara ka vazhduar dhe do të vazhdojë deri sa Këshilli i Bashkimit Evropian të njoftojë për përfundimin e mandatit të tyre.³

¹ “Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo”. Dick Marty. 7 janar 2011 (Shih linkun: <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=12608>). Qasur për herën e fundit më 21 dhjetor 2020.

² Ligji nr. 04/L-274 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë.

³ Aktgjykim mbi referimin e amendamenteve të propozuara të Kushtetutës së Kosovës, nr. KSC-CC-2020-11. 26 nëntor 2020.

3. Ftesat dhe aktakuzat e para të Speciales

Në fundin e vitit 2018, nga Zyra e Prokurorit të Specializuar kishin filluar të vijnë ftesat e para për persona të dyshuar dhe për dëshmitar. Ftesat kishin vazhduar edhe gjatë dy viteve në vazhdim, ashtu që deri në dhjetor të vitit 2020, qindra persona nga Kosova janë ftuar në Zyrën e Prokurorit të Specializuar për tu intervistuar, qoftë si të dyshuar apo edhe si dëshmitar. Një pjesë e këtyre intervistimeve ishte bërë në Hagë, ndërsa intervistime ishin bërë edhe në Kosovë dhe vende tjera.

Në shkurt të vitit 2020, Kryeprokurori i Zyrës së Prokurorit të Specializuar Jack Smith, kishte njoftuar kryetaren e Dhomave të Specializuara, Ekaterina Trendilova se do të fillojë me ngritjen e aktakuzave të para.

Aktakuza e parë që ishte konfirmuar nga Gjykata Speciale kishte qenë ajo ndaj ish-prororit të UÇK-së, Sali Mustafa, e cila ishte pasuar pastaj nga një aktakuzë që ishte konfirmuar në muajin nëntor 2020, ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryetarëve të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi dhe deputetit të Kuvendit të Kosovës, Rexhep Selimi.⁴ Në dhjetor 2020, Gjykata kishte konfirmuar edhe një aktakuzë ndaj udhëheqësve të Organizatës së Veteranëve të Luftës, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.

Aktualisht, për publikun janë të njohura tri (3) aktakuza që janë konfirmuar nga Dhomat e Specializuara, me gjithsej shtatë (7) të akuzuar. Në të tri rastet, procedurat për nisjen e gjykimit janë ende në fazën fillestare.

4. Korniza ligjore për ndihmën e të akuzuarve të Speciales

Ligji nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, në nenin 21.4.e. të tij, ka përcaktuar se çdo i akuzuar mund mbrohet përmes Mbrojtësit të Specializuar të zgjedhur prej tij apo të informohet, nëse nuk ka ndihmë ligjore, për këtë të drejtë dhe t'i caktohet Mbrojtës i Specializuar. Sipas ligjit, të akuzuarve do tu caktohen mbrojtës në raste kur të njëjtit nuk kanë mundësi t'i paguajnë ata apo kur kjo kërkohet për interesa të drejtësisë. Kësisoj, të gjithë të akuzuarit që i plotësojnë kushtet e parapara, mund tu sigurohet ndihmë juridike pa pagesë nga Dhomat e Specializuara.

Në të njëjtën ditë kur ishin miratuar amendamentet kushtetuese dhe ligji me të cilin ishin themeluar Dhomat e Specializuara, Kuvendi i Kosovës kishte miratuar edhe Ligjin nr. 05/L-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara. Ashtu siç e përcakton edhe emërtimi i tij, ky ligj ka synim që tu ofrojë mbrojtje juridike dhe mbështetjen financiare personave të

⁴ “Hashim Thaçi jep dorëheqje nga posti i presidentit pasi i konfirmohet aktakuza”. Betimi për Drejtësi. 5 nëntor 2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/hashim-thaci-jep-doreheqje-nga-posti-i-presidentit-pasi-i-konfirmohet-aktakuza/>). Qasur për herën e fundit, 21 dhjetor 2020.

akuzuar potencial në proceset gjyqësore dhe procedurat e ndërlidhura, për krimet e pretenduara pranë Dhomave të Specializuara. Pra, ky ligj ofron një “dritare” tjetër ndihme për të akuzuarit e Speciales, krahas ndihmës që mund të sigurohet edhe nga vet Dhomat e Specializuara.

Siç e përcakton ky ligj, çdo i akuzuar mund të bëjë një kërkesë për asistencë me të cilën do të mbulohen shpenzimet e mbrojtjes së tij, nga ana e Buxhetit të Kosovës. Po ashtu, ligji ka paraparë edhe mbështetje financiare për familjarët e të akuzuarve për udhëtimet e tyre në Hagë si dhe kompensim për të akuzuarit në rast se shpallen të pafajshëm. Ligji në fjalë nuk ka përcaktuar ndonjë kriter të veçantë për të përfituar mbulimin e shpenzimeve nga ana e Qeverisë, duke ju lënë hapësirë të gjithë të akuzuarve potencial të jenë përfitues.

Për plotësimin e kuadrit ligjor të këtij ligji, Ministria e Drejtësisë ka miratuar edhe tri udhëzime administrative. Konkretisht, MD ka miratuar një udhëzim për *mbrojtje juridike të akuzuarve të Speciales*⁵, një udhëzim për *kompensim të akuzuarve që mund të shpallen të pafajshëm*⁶ dhe një udhëzim për *mbështetje financiare të familjarëve të akuzuarve*.⁷

⁵ **Shënim:** Udhëzimi Administrativ nr.02/2020, ishte plotësuar/ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.07/2020.

⁶ Udhëzim Administrativ MD - Nr. 04/2020.

⁷ Udhëzim Administrativ MD – Nr.03/2020.

⁸ “Kush i paguan avokatët pranë Gjykatës në Hagë?”. evropaelirë.org. 22 nëntor 2020 (Shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/avokatet-uck-gjykata-speciale-/30962225.html>) Qasur për herën e fundit më 21 dhjetor 2020.

⁹ **Shënim:** Qeveria ka bërë edhe pagesa tjera që ndërlidhen me Dhomat e Specializuara përfshirë kontrata me firma amerikane dhe britanike për

Në korrik 2020, MD kishte miratuar UD nr.02/2020 për *mbrojtjen juridike të personave të akuzuar potencial për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë dhomave të specializuara*, në nenin 12 të së cilit, parashiheshin një sërë veprimesh të mbrojtësve së të akuzuarve, të cilat nuk mbuloheshin nga Buxheti i Kosovës, siç ishin, shpenzimet për angazhimin e stafit shtesë, shpenzimet e qirasë për zyrë, telefon etj. Por, në nëntor të këtij viti, MD kishte plotësuar dhe ndryshuar UD në fjalë me UD nr.07/2020, ashtu që tashmë, nga Buxheti i Kosovës pritet të paguhet edhe këto veprimtari të mbrojtësve së të akuzuarve që ishin përjashtuar nga pagesa sipas udhëzimit paraprak.

Deri në nëntor të vitit 2020, Qeveria e Kosovës kishte ndarë 61 mijë euro për procesin në Hagë për personat që po dyshohen nga Zyra e Prokurorit të Specializuar për krime.⁸⁹

Përveç caktimit të një mbrojtësi sipas detyrës zyrtare nga ana e Gjykatës dhe asistencës nga Qeveria për mbulim të shpenzimeve të mbrojtjes, të akuzuarit kanë mundësinë që edhe vet të angazhojnë avokat me mjetet e tyre. Për këtë qëllim, deri tash janë themeluar dy fondacione, një për ish-presidentin Thaçi¹⁰ dhe një për ish-kryetarin e Kuvendit Veseli.¹¹

“këshillim ligjor për hartimin, zhvillimin dhe prezantimin e pozitës ligjore të Kosovës” pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës.

¹⁰ “Themelohet Fondacioni “Përkrahje për Mbrojtjen Juridike të Hashim Thaçit”. telegrafi.com (Shih linkun: <https://telegrafi.com/themelohet-fondacioni-perkrahje-per-mbrojtjen-juridike-te-hashim-thacit/>) Qasur për herën e fundit më 21 dhjetor 2020.

¹¹ “Themelohet fondacioni “Përkrahje për mbrojtjen e Kadri Veselit”. telegrafi.com (Shih linkun: <https://telegrafi.com/themelohet-fondacioni->

5. “Konfidencialiteti” i shpenzimit të parasë publike për të akuzuarit e Speciales

Në Ligjin nr.05/L-054 për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë dhomave të specializuara, në asnjë nen nuk ceket se shpenzimet në fjalë do të trajtohen si “konfidenciale”, edhe pse vet ligji, shumë gjëra i lë të rregullohen përmes akteve nënligjore.

Por, në nenin 17 të UD nr.02/2020, është paraparë që trajtimi i të gjitha materialeve lidhur me mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes juridike si dhe të çështjeve tjera që ndërlidhen me mbulimin e shpenzimeve në fjalë të bëhen në harmoni me legjislacionin në fuqi për klasifikimin e informacioneve si dhe Vendimin e Kryeministrit Nr.2192/2019, të datës 31.01.2019.

Në UD nr.07/2020, që është plotësim/ndryshim i udhëzimit nr.02/2020, është e bashkangjitur edhe një “model i marrëveshjes për përfaqësim”, ku ndër të tjera, në nenin 4, është paraparë si rreptësisht konfidenciale çdo komunikim i ministrisë dhe mbrojtjes së të akuzuarit.

Duke u bazuar në UD nr.02/2020 dhe vendimin e ish-kryeministrit Haradinaj, nr.2192/2019, MD-ja ka refuzuar kërkesat e bëra nga mediat për qasje në dokumente që ndërlidhen me shpenzimet për të akuzuarit.¹²

E vet vendimi i ish-kryeministrit Haradinaj, të cilit i referohet MD-ja, nuk parasheh

ndonjë konfidencialitet kur bëhet fjalë për mbulimin e shpenzimeve për të akuzuarit e Speciales.

Në nenin 1 të vendimit në fjalë, thuhet se “*Informacionet që ndërlidhen me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar janë informacione të nivelit “SEKRET” dhe mbrohen nga qasja e personave të paautorizuar*”, kurse në nenin 2 të vendimit thuhet se “**Përfashtim** nga pika 1 e këtij vendimi janë informatat që kanë të bëjnë me **mjetet e shpenzuara financiare** përkitazi me mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare që ndërlidhet me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar”.

Nisur nga kjo, sipas nenit 2 të vendimit të ish-kryeministrit Haradinaj, del se nuk janë klasifikuar si sekrete mjetet e shpenzuara për mbrojtjen juridike financiare për të akuzuarit e Speciales.

perkrahje-per-mbrojtjen-e-kadri-veselit/) Qasur për herën e fundit më 21 dhjetor 2020.

¹² “Faturat sekrete”. koha.net. 21 tetor 2020 (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/242282/faturat-sekrete/>).

sekrete/). Qasur për herën e fundit më 21 dhjetor 2020.

6. Transparenca e munguar

Mjetet me të cilat sipas ligjit është planifikuar të mbulohen shpenzimet për mbrojtje të akuzuarve të Speciales, janë fonde publike që burimin e tyre e kanë në Buxhetin e Kosovës.¹³

Kushtetuta e Kosovës, në nenin 120 ka përcaktuar se *“Shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës”*.

Por, qasja që deri më tani e ka përcjellë procesin e ndarjes së mjeteve për mbrojtje të të akuzuarve bie në kundërshtim me këto parime që janë përcaktuar nga Kushtetuta.

Siç u tha edhe më lartë, Qeveria e Kosovës, konkretisht MD-ja, duke u thirrur në një udhëzimin administrativ që kishte nxjerr për mbështetje financiare të të akuzuarve të Speciales si dhe një vendim të ish-kryeministrit Haradinaj, ka kufizuar qasjen e publikut në informacionet se ku dhe si po shpenzohet Buxheti i Kosovës kundrejt kësaj mbështetje.

Kjo qasje e Qeverisë së Kosovës për të mos i bërë transparente shpenzimet për të akuzuarit e Speciales, ndikon drejtpërdrejtë në cenimin e parimit të transparencës, llogaridhënies, trajtimit të barabartë të akuzuarve dhe i hap rrugë edhe abuzimeve me paratë publike. Në këtë kontekst, MD ka dështuar të vë në pah se shpenzimi i parave publike për të cilat po kërkohet transparenca nuk mund të cilësohen si çështje private të individëve.

Në UD nr.02/2020, thuhet se dokumentacioni për mbulimin e

shpenzimeve të mbrojtjes juridike për proceset në Hagë do trajtohen në pajtim me legjislacionin në fuqi për klasifikimin e informacioneve. Qëllimi i Ligjit nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, i cili e rregullon këtë fushë që i referohet udhëzimi administrativ, ndër të tjera e ka paraparë krijimin e një sistemi unik për klasifikimin dhe ruajtjen e informacioneve që kanë të bëjnë me interesat e sigurisë së Kosovës.

Nisur nga kjo, del se pagesat për avokatët e të akuzuarve nga Specialja, Qeveria i ka konsideruar diçka që ka të bëjë me interesat e sigurisë së Kosovës përkundër asaj se është mesë e qartë se në Dhomat e Specializuara janë duke u gjykuar individë, paçka se të njëjtit kanë mbajtur pozitat më të larta në Kosova.

Ligji për Klasifikimin e Informacioneve, e ka përcaktuar si informacion të klasifikuar *“çdo informacion dhe material, publikimi i paautorizuar i të cilave do të cenonte në shkallë të ndryshme interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës”*. Përkitazi me këtë, është krejt e paqartë se si publikimi i faturave të pagesave nga Buxheti i Kosovës, për avokatët e të akuzuarve do të cenonte interesat e sigurisë së Kosovës. Duke qenë se kemi të bëjmë me një proces krejtësisht juridik, nuk ka asnjë sinjal se publikimi i informatave financiare lidhur me pagesat që bëhen nga një buxhet publik për avokatë të të akuzuarve do të cenonte jo vetëm sigurinë e Kosovës por as që do të ndikonte në gjykimin e të akuzuarve. Këta të fundit, kanë mundësinë e angazhimit edhe të avokatëve me mjete të tyre, për të cilat pagesa nuk është kontestuese jo

¹³ Neni 3 i Ligjit nr. 05/L-054 për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar

potencial në proceset gjyqësore pranë dhomave të specializuara.

obligueshmëria e tyre për t'i bërë publike pagesat e të njëjtëve.

Në nenin 4 të Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë janë të listuara gjashtë (6) kategori të informacioneve të cilat mund të klasifikohen, ku përfshihen informacionet që bien në kategorinë:

“1.3.1. siguri publike;

1.3.2. mbrojtje, plane ushtarake, sisteme armësh, apo operacione;

1.3.3. informacione për marrëdhëniet me jashtë dhe qeveritë e jashtme, përfshirë burimet konfidenciale;

1.3.4. veprimtari zbulimi dhe të zbatimit të ligjit, përfshirë metoda dhe burime të zbulimit;

1.3.5. sisteme, instalime, infrastruktura, projekte, plane apo shërbime të mbrojtjes që lidhen me interesat e sigurisë të Republikës së Kosovës;

1.3.6. veprimtari shkencore, teknologjike, ekonomike, financiare që lidhen me interesat thelbësore të sigurisë së Republikës së Kosovës”.

Siç shihet, informacionet që mund të klasifikohen, sipas kategorive të lartcekura janë informacione të cilat prekin shtetin në tërësi, çka e bën të pabazuar qëndrimin e Qeverisë se pagesat e avokatëve të

individëve që akuzohen nga Specialja, janë çështje që mund të interesat shtetërore.

Madje, Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, në nenin 5 të tij ka paraparë edhe rastet kur ndalohet klasifikimi i informacioneve e ku ndër të tjera parashihet ndalimi i klasifikimit të informacioneve për të “1.1. *fshehur shkeljet e ligjit, abuzimin e autoritetit, mos efikasitetin apo gabimin administrativ*”. Në rastin konkret, mos transparenca kur vjen çështja te pagesa e mbrojtjes së të akuzuarve të Speciales, mund të bie pikërisht nën këtë nen të ligjit në fjalë, pasi do linte mundësi që në emër të konfidencialitet, të abuzohet me parane publike.

Kjo sidomos duke pasur parasysh se me udhëzimet administrative të MD-së, është lënë mundësia që MD të lejoj tejkalimin e shumave të përcaktuara për ndihmë juridike¹⁴ apo edhe i është lënë në diskrecion të negociojë për pagesa fikse mujore me mbrojtësit.¹⁵ Po ashtu, në fazën e ankesave, UD nr.02/2020 i jep autoritet ministrit si autoritet final brenda administratës që të vendos si i vetëm lidhur me rastet kur refuzohen kërkesat për ndihmë apo tejkalohe shumat e caktuara në vendim.¹⁶

Rrjedhimisht, pagesat për avokatët e të akuzuarve të Speciales bëhen nga fondet publike, andaj është jashtëzakonisht e rëndësishme që qytetarët e Kosovës të kenë informacionin e nevojshëm se si po shpenzohet paraja e tyre.

Një ndër mënyrat me efikase se si qytetarët e bëjnë mbikëqyrjen e shpenzimeve të

¹⁴ Neni 11.2 dhe 11.3 i UD nr.02/2020.

¹⁵ Neni 5.4 i UD nr.07/2020.

¹⁶ Neni 16.2 i UD nr.02/2020.

parave publike nga institucionet publike është përmes dokumenteve dhe informacioneve publike në të cilat mund të kenë qasje. Të drejtën për qasje në dokumente publike, qytetarëve u garanton Kushtetuta e Kosovës¹⁷ si dhe ligjet në fuqi. Në parim, kjo e drejtë për qasje në dokumente publike konsumohet brenda të drejtës së lirisë dhe shprehjes dhe si e tillë, e njëjta është e garantuar edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut që është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë¹⁸. Kësisoj, e drejta për qasje në dokumente publike e secilit qytetarë dhe garantimi i kësaj të drejte nga ana e institucioneve publike përbën një prej themeleve të institucioneve demokratike dhe transparente.

Në këtë frymë, Qeveria e Kosovës, duke u bazuar në Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, e ka obligim ligjor që në mënyre proaktive t'i bëj publike dokumentet si dhe të përgjigjet në kërkesat e personave për qasje në dokumente publike, çka në rastin e dokumenteve për shpenzimet e mbrojtjes së të akuzuarve të Speciales ka dështuar ta bëj.

Neni 4 i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, përcakton se hapja e të dhënave dhe transparenca në sektorin publik shërben për llogaridhënie ndaj publikut, për zhvillimin dhe avancimin shoqëror, ekonomik dhe demokratik.

Për më tepër, paragrafi 3.1 i nenit 17 të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në

Dokumente Publike, në mënyrë eksplicite e ka përcaktuar se:

“Qasja në dokumente publike gjithnjë lejohet, nëse: 3.1. dokumenti publik i kërkuar ka të bëjë me shpenzimet e parasë publike”.

Në rastin konkret, tek dokumentet e pagesave të avokatëve të akuzuarve të Speciales nga Buxheti i Kosovës, Qeveria ka kufizuar pikërisht qasjen në dokumente që kanë bëjnë me shpenzimet e parasë publike dhe ka vepruar në kundërshtim me interesin e publikut, që kërkon transparencë dhe llogaridhënie se ku po shpenzohen taksat e tyre.

Gjithashtu, sipas këtij ligji, institucionet publike para se të refuzojnë qasjen në dokumente publike janë të obliguara të bëjnë edhe testin e dëmit dhe interesit publik, çka në rastin konkret nuk ka ndonjë informacion se kjo kërkesë ligjore është përfillur.¹⁹

Në këtë rast, për publikun e Kosovës janë të njohur të akuzuarit, siç janë të njohur edhe mbrojtësit të cilët i mbrojnë ata. Po ashtu, edhe aktakuzat e ngritura, ndonëse të redaktuara, janë të qasshme për publikun. Gjithashtu, qytetarët tashmë e dinë se një pjesë e taksave të tyre do të shkojnë për pagesën e avokatëve të të akuzuarve. Rrjedhimisht, e vetmja gjë e pazbuluar në këtë kontekst, mbetet shumica e parave që ju ndahen mbrojtësve së të akuzuarve. Një çështje e tillë, pra publikimi i këtyre shumave, nuk ka asnjë mundësi të ndikojë

¹⁷ Neni 41 i Kushtetutës së Kosovës.

¹⁸ Aktgjykimi i GjEDNj-it. Rasti Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë. Kërkesa nr. 18030/11. 8 nëntor 2016.

¹⁹ Neni 17.1 i Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

në çështjet që po gjykohen në Hagë, në kuptim të forcimit apo dobësimit të pozitës së të akuzuarve atje. Njëkohësisht, nuk ka asnjë indikacion se bërja transparente për publikun e këtyre informacioneve, ku dokumentohen shpenzimi i parasë publike do të cenonte interesin e Kosovës apo të ndonjë pale tjetër. Rrjedhimisht, në këtë situatë, nëse edhe ekziston ndonjë cenim i interesit të ndonjë individ, i njëjti cenim i supozuar edhe mund të arsyetohet me interesin e publikut si tërësi për ta pasur informacionet e nevojshme lidhur me shpenzimin e parave publike.

Bazuar në krejt këtë, duke qenë se udhëzimi administrativ i MD-së është dokument më i ulët juridik në hierarkinë e akteve juridike, i njëjti nuk mund të ndërtohet në kundërshtim me parimet që janë ndërtuar edhe nga Kushtetuta e as të tejkaloj ligjin bazë në këtë rast, Ligjin për mbrojtje për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë dhomave të specializuara.

6.1 Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), në rastin Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë²⁰, kishte konstatuar se janë katër (4) rrethana të cilat duhet të merren për bazë për të vlerësuar nëse refuzimi për qasje në dokumente përbën shkelje të së drejtës së shprehjes.

Sipas GjEDNj-it, këto katër kritere janë:

- 1) qëllimi i informacionit;
- 2) natyra e informacionit që kërkohet;
- 3) roli i kërkuesit të informacionit; dhe
- 4) informacioni është i gatshëm dhe i disponueshëm.

Sa i përket *qëllimit të informacionit*, gjykata thekson se marrja e informacionit do të konsiderohej e domosdoshme nëse mbajtja e tij do të pengonte ose dëmtonte ushtrimin e të drejtës së individit për lirinë e shprehjes, përfshirë këtu edhe lirinë "për të marrë dhe për të dhënë informacion". Sa i përket *natyrës së informacionit*, gjykata thekson se informacioni ose të dhënat dhe dokumentet në të cilat kërkohet hyrja duhet të përmbushin në përgjithësi një test me interes publik në mënyrë që të nxisin një nevojë për zbulim sipas Konventës.

Sipas gjykatës, një nevojë e tillë mund të ekzistojë kur, ndër të tjera, zbulimi siguron transparencë për mënyrën e kryerjes së punëve publike dhe për çështjet me interes për shoqërinë në tërësi dhe në këtë mënyrë lejon pjesëmarrjen në qeverisjen publike nga publiku në përgjithësi.

Sa i përket kriterit të *rolit të kërkuesit të informacionit*, sipas GjEDNj-it, edhe pse liria e shprehjes garantohet për të gjithë pa

²⁰ Aktgjykimi i GjEDNj-it. Rasti Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë, kërkesa nr. 18030/11, 8 nëntor 2016.

dallim, gjykata në praktikën e saj ia ka njohur rolin esencial që mediat dhe organizata jo-qeveritare kanë pasur në një shoqëri demokratike duke theksuar se gjykata i jep një rëndësi faktit nëse personi që kërkon qasje në informacionin në fjalë e bën këtë me qëllim të informimit të publikut në cilësinë e një "vëzhguesi" publik.

Si kriter të fundit, Gjykata përcakton atë nëse *informacioni është i gatshëm dhe i disponueshëm*, duke hedhur poshtë rastet kur kërkesat ishin refuzuar nga ana e institucioneve me arsyetimin se do të kishte vështirësi në mbledhjen e informacioneve të kaluara, për shkak të praktikave të vet institucioneve në fjalë e jo rrethanave tjera.

Lidhur me këto kriterë, GjEDNJ ka theksuar se të njëjtat vlerësohen për secilin rast veç e veç. Nëse tërheqim një paralele me rastin konkret, atë të dokumentacionit për shpenzimet publike në mbrojtjen e të akuzuarve të Speciales, mund të arrijmë në një përfundim se kriteret e përcaktuara nga GjEDNJ, plotësohen kumulativisht.

Në rastin konkret, mbajtja e fshehur e informatave dhe dokumenteve për shpenzimet për mbrojtje të të akuzuarve të Speciales, në masë të madhe do të ndikonte në privimin e publikut nga e drejta për të marrë një informacion se ku po shpenzohet taksat e tij.

Gjithashtu, sa i përket natyrës së informacionit publik, në rastin konkret të dhënat që kërkohen në këtë rast nga MD-ja, e përmbushin testin e interesit publik, siç e potencon gjykata, pasi kemi të bëjmë me fonde publike, që menaxhohen nga institucionet publike, vendimet e të cilave prekin secili qytetar të Kosovës.

Vet gjykata e thekson se kjo nevojë përmbushet kur zbulimi i të dhënave në fjalë, sigurojnë transparencë për mënyrën e kryerjes së punëve publike.

Sa i përket rolit të kërkuesit të informacionit, në rastin konkret janë mediat dhe shoqëria civile në Kosovë ato të cilat kërkojnë qasje në këto të dhëna të MD-së, e të cilat sipas edhe vet gjykatës, në shoqëritë demokratike luajnë rolin e "vëzhguesit" publik.

Sa i përket kriterit të fundit, një pjesë e dokumentacionit që kërkohet nga MD-ja, për pagesat e shpenzimeve për mbrojtje të akuzuarve, me siguri që duhet të jetë i gatshëm dhe i disponueshëm, pasi në të kundërtën, nëse pagesat janë kryer pa u plotësuar dokumentacion në fjalë, atëherë MD-jë me këtë rast do të kryente edhe shkelje ligjore që do të mund të hynin edhe në sferën penale.

7. Qasja selektive dhe mundësia për abuzimin e parave publike

Deri në dhjetor të vitit 2020, janë me qindra ftesa që kanë ardhur nga ZPS për tu intervistuar persona të ndryshëm në Kosovë. Një numër i madh i këtyre personave, janë ftuar që të intervistohen në cilësi të dyshuarve.

Përkundër se Ligji për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë dhomave të specializuara, ka përcaktuar se asistencë në mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes u ofrohet personave të akuzuar, në realitet, Qeveria në të paktën tre raste ka ndarë mjete nga buxheti publik për persona që janë

intervistuar në cilësinë e të dyshuarve dhe jo të akuzuarve.²¹²²

Po ashtu, edhe UD nr.02/2020, i MD-së, ka përcaktuar se asistencë në mbulimin e shpenzimeve për mbrojtjen juridike të personit të akuzuar, bëhet nga momenti i ngritjes së aktakuzës. Qasja e tillë e Qeverisë, kur ka ndarë mjete nga buxheti publik për mbështetje të disa personave që janë ftuar për intervistim si të dyshuar, ndërsa nuk e ka bërë një gjë të tillë për disa qindra persona tjerë që po ashtu ishin ftuar për tu intervistuar të dyshuar, tregon për qasje selektive nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Një qasje e tillë selektive, ka gjasa të vazhdojë nëse Qeveria vazhdon të mos lejoj qasje në dokumentet e pagesave për mbrojtjet e të akuzuarve të Speciales pasi do të linte në “terr” informativ të gjitha palët tjera.

As ligji për mbrojtjen juridike të akuzuarve të speciales e as udhëzimet administrative të MD-së, nuk kanë vënë një “kapak” për sa i përket lartësisë së asistencës financiare që mund të paguhet nga Buxheti i Kosovës për avokatët e të akuzuarve. UD nr.02/2020, ka paraparë katër lloje të tarifave, duke përfshirë, tarifat e përcaktuara nga Oda e Avokatëve të Kosovës, tarifat për avokatë në Holandë, tarifat e shtetit prej nga vjen

mbrojtësi dhe tarifat për mbrojtje juridike të personit të akuzuar potencial të Dhomave të Specializuara. Përkundër këtyre tarifave, në nenin 11.2 ka lënë mundësinë edhe të tejkalimit të shumës së përcaktuar në vendim për pagesë.

Dyshimet për abuzim me parane publike në ndarjen e mjeteve për ndihmë të akuzuarve të Speciales, ishin theksuar edhe në kërkesën për arrestimin e ish-presidentit Thaçi, nga ana e kryeprokurorit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Jack Smith. Sipas Zyrës së Prokurorit të Specializuar, paratë që paguheshin nga ana e Divizionit brenda MD-së, nuk ishin dhënë në përputhje me kritere të qëndrueshme dhe se kanë pasur pak lidhje ndaj shpenzimeve legjitime.²³

Nevoja për transparencë dhe llogaridhënie në rastin e asistencës financiare për të akuzuarit të Speciales, bëhet më se e nevojshme kur tashmë janë ndarë një shumë prej 20 milionë euro për këtë kategori.²⁴ Deri më tani, kemi shtatë (7) persona të akuzuar dhe nëse ky numër i të akuzuarve rritet, atëherë pa dyshim edhe shuma e mjeteve që do të ndahet për këtë kategori do të vazhdon të rritet.

²¹ Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr.10/88.. 5 shkurt 2019 (Shih linkun: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/10/Vendimet-e-mbledhjes-88-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>) Qasur për herën e fundit më 21 dhjetor 2020.

²² Vendimi i Qeverisë së Kosovës, nr. 14/94. 19 mars 2019 (Shih linkun: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/10/Vendimet-e-mbledhjes-94-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>) Qasur për herën e fundit më 21 dhjetor 2020.

²³ “Të gjitha arsyet pse ZPS kërkoi arrestimin e Thaçit e të tjerëve, thuhet se ndërhyjnë në proces dhe të dëshmitarët”. Betimi për Drejtësi. 20 nëntor 2020.

(Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/te-gjitha-arsyet-pse-zps-kerkoi-arrestimin-e-thacit-e-te-tjereve-thuhet-se-nderhyne-ne-proces-dhe-te-deshmitaret/>) Qasur për herën e fundit më 21 dhjetor 2020.

²⁴ “Selimi: 20 milion euro do të shfrytëzohen për mbrojtjen e të akuzuarve nga Specialja”. kosovapress.com.14 dhjetor 2020. (Shih linkun: <https://kosovapress.com/selimi-20-milione-euro-do-te-shfrytezohen-per-mbrojtjen-e-te-akuzuarve-nga-specialja/>) Qasur për herën e fundit më 21 dhjetor 2020.

8. Rekomandime

Instituti i Kosovës për Drejtësi i rekomandon Qeverisë së Kosovës, që të gjithë procesin e mbrojtjes juridike dhe mbështetjes financiare të akuzuarve në proceset gjyqësore në dhomat e specializuara të bëj duke u bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe barazisë.

IKD i rekomandon Qeverisë, që ndihma financiare për të akuzuarit të mos jepet në mënyra selektive siç ka ndodhur në të kaluarën dhe të mos krijohen të akuzuar të “privilegjuar” në këtë aspekt.

Në këtë frymë, IKD i rekomandon Qeverisë që t’i bëj publike të gjitha dokumentet që ndërlidhen me asistencën financiare që u jepet të akuzuarve nga fondet publike të Kosovës.